

Kthimi vullnetar

Albanisch/Albanian
Informationen für Asylbewerberinnen und Asylbewerber
Informacione për azilkërkuesë dhe azilkërkues

Çfarë ndodh nëse ju refuzohet kërkesa juaj për azil?

Së bashku me refuzimin e kërkesës për azil, njoftoheni edhe për një afat brenda të cilit duhet të largoheni. Zakonisht ky afat është 30 ditë. Në rastin e refuzimit të një kërkesë për azil si „qartazi e pabazuar“, afati i largimi është një javë. Nëse nuk largoheni me vullnet të lirë, mund të ktheheni me detyrim në vendin tuaj të origjinës (riatdhesim). Shpenzimet për riatdhesimin tuaj duhet t'i paguani vetë dhe për shumë vjet nuk keni më mundësinë të udhëtoni në rrugë të ligjshme në Gjermani ose në një shtet tjetër të BE-së (ndalim udhëtimi). Pa dokumente lejeqëndrimi nuk mund të qëndroni në Gjermani: Në çdo kohë duhet të llogarisni me arrestim nga policia dhe riatdhesim në vendin tuaj të origjinës.

Vendosni për një kthim me vullnet të lirë me mbështetje të autoriteteve gjermane

Nëse nuk keni para për ta financuar vetë udhëtimin e kthimit, ju jepet mundësia për të marrë mbështetje nëpërmjet programit të kthimit REAG/GARP. REAG/GARP qendron për „Programi i riintegritimit dhe migrimit për azilkërkuesit në Gjermani/Programi mbështetës qeveritar për riatdhesim“ (Reintegration and Emigration Programme for Asylum-Seekers in Germany/Government Assisted Repatriation Programme). Një mbështetje ju bën të mundur që të udhëtoni në mënyrë të pavarur dhe ta përgatitni me kujdes udhëtimin e kthimit. Bëhet organizimi i udhëtimit të kthimit dhe merren përsipër shpenzimet e udhëtimit dhe, përveç kësaj, ekziston mundësia për mbështetje të tjera shtesë në formën e një kompensimi për shpenzime udhëtimi ose ndihme fillestare. Përveç kësaj, për personat që kthehen vullnetarisht në vende të caktuara të origjinës ka në dispozicion oferta të tjera mbështetjeje, për të lehtësuar një fillim të ri në vendin e origjinës, për shembull gjatë kërkimit për punë ose për banesë. Mundësitë e ndryshme mund të diskutohen në kuadër të një këshillimi personal për kthimin.

Shfrytëzoni këshillimin falas për kthimin që ju jepet këtu në vend



Nëse interesoheni për një kthim me vullnet të lirë në vendin tuaj të origjinës, për të gjitha pyetjet mund t'i drejtoheni me plot besim këshillimit për kthimin. Këshillimi për kthimin ju ofron mbështetje gjatë përgatitjes së udhëtimit të kthimit, të paraqitjes së kërkesës për mbështetje REAG/GARP dhe, kur është me vend, për të kërkuar ndihma të tjera për personat që kthehen në mënyrë vullnetare. Nëse nuk keni një dokument të vlefshëm udhëtimi, ju jepet edhe mbështetje për të marrë një dokument zëvendësues të pasaportës. Në bisedën këshillimore është parashikuar prania e një përkthyesje ose përkthyesi për t'u siguruar që të kuptoni çdo gjë. Keni gjithashtu të drejtën që në zyrën e këshillimit për kthimin të sillni vetë një person, i cili përkthen për ju.

Madje edhe kur kërkesa për azil është në proces mund të kërkonti këshillim për kthim, pa pasur ndikime në rezultatit e procesit.

Gjithashtu, kthimi me vullnet të lirë është i mundur edhe nëse procesi për azil nuk ka mbaruar ende. Në këtë rast, kërkesën për azil duhet ta tërhiqni para udhëtimit të kthimit. Pas tërheqjes së kërkesës për azil, Zyra Federale për Migracionin dhe Refugjatët (BAMF) dërgon dokumentet tuaja të udhëtimit

në Zyrën përgjegjëse të të Huajve (Zyra e të Huajve që ju ka lëshuar lejen e qëndrimit) nga ku mund t'i tërhiqni.

Këshillimin për kthim e gjeni këtu në vend në adresën e mëposhtme:

Elisa Müller
Amt für Migration und Integration
Schützenstraße 69; 88212 Ravensburg
2. OG, Raum 219
Tel.: 0751/85-9857
E.Mueller@rv.de

Sebastian Leidinger
Amt für Migration und Integration
Schützenstraße 69; 88212 Ravensburg
2. OG, Raum 219
Tel.: 0751/85-9886
S.Leidinger@rv.de

Nëse keni qasje në internet, në faqet e mëposhtme të internetit mund të merrni informacione të mëtejshme në lidhje me kthimin me vullnet të lirë: www.ReturningfromGermany.de/sq/